



Pranuar / Dorezuar Punimje/Protato Received/Deliverty	04.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Protog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKIMSHICK	4046	2023	112



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.614/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.614/2023 të datës 05.04.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Komisionit të pranimit për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm në Komunën e Deqanit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.614/2023 të datës 05.04.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Deqanit për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm/në pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile, me nr.të ref.RN00010613 publikuar me datë 15.12.2022, me datën 05.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3303/05.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komisionit të Pranimit për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm/Zyrtar i Gjendjes Civile në Komunën e Deqanit.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 18.04.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Deqanit. Ndërsa



Këshilli me datën 04.05.2023 përmes e-mailit zyrtar ka pranuar të njëjtën deklaratë të cilën ankuesi e ka paraqit në Këshill për tërheqjen e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ të filluar me ankesën me numër A.nr.614/2023 të datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, konstaton se ankuesi me datë 05.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3303/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 28.04.2023 ankuesi përmes deklaratës me numër protokoll ka kërkuar që të bëjë tërheqjen e ankesës të datës 05.04.2023 të parashtruar në Këshill pa asnjë presion për shkaqe personale. Kolegji i Këshillit bazuar në këto rrethana, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj në këtë kuptim është vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.614/2023, datë 04/05/2023.

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Deqanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

